



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE  
BORDI

VENDIM

Nr. 231, datë 15.11.2021

MBI

**HEQJEN E LICENCËS NR. 360, SERIA T17, PËR VEPRIMTARINË E TREGTIMIT  
TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË SHOQËRISË “BALKAN ENERGY TRADE”  
SH.P.K. ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 37, DATË 06.03.2017**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 17, pika 4 dhe nenit 42, pika 1, gërma “ç” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 5, gërma “ç” dhe nenit 9, gërma “c” të Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.04.2017; nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; si dhe pikës 3.6.4 dhe pikës 5.1, gërma “ç” të “Kushteve të licencës për Veprimtarinë e Tregtimit të Energjisë Elektrike” miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 97, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.11.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 140/3 prot., datë 10.11.2021, të përgatitur nga Grupi i Punës “Mbi heqjen e licencës nr. 360, seria t17, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Balkan Energy Trade” sh.p.k. me vendimin e bordit të ERE-s nr. 37, datë 06.03.2017”

**Konstatohet se:**

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 192, datë 10.09.2021, vendosi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 360, Seria T17, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Balkan Energy Trade” sh.p.k., me vendimin e bordit të ERE-s nr. 37, datë 06.03.2017, për arsye se shoqëria “Balkan Energy Trade” sh.p.k. nuk kishte shlyer në afat ndaj ERE-s pagesën rregullatore të vitit 2020 për licencën për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, e po ashtu nuk kishte depozituar në ERE asnjë dokument apo argument në lidhje me moszbatimin e këtij detyrimi.
- Me shkresën nr. 948 prot., datë 15.09.2021, ERE i ka njoftuar shoqërisë vendimmarrjen si më sipër, duke i bërë me dije se ka të drejtën për t’u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së këtij njoftimi. Po ashtu kjo shkresë i është dërguar shoqërisë e skanuar me postë elektronike.
- Vendimi i bordit të ERE-s nr. 193, datë 10.09.2021, është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 154, datë 05.10.2021. Shkresa e dërguar shoqërisë është kthyer nga posta. Në këto

rrethana, përveç sa më sipër, shoqëria nuk ka zbatuar dhe përcaktimet e pikës 3.6.4 të kushteve të licencës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, ku është parashikuar detyrimi i të licencuarve për të njoftuar ERE-n brenda 10 ditëve për çdo ndryshim të adresës.

- Pas përfundimit të afatit të përcaktuar në njoftimin e vendimit të sipërcituar (duke e përllogaritur këtë afat 30 ditë nga marrja dijani nga publikimi në Fletoren Zyrtare) rezultoi se subjekti nuk ka marrë asnjë masë për shlyerjen e debisë apo për të dhënë shpjegime në lidhje me këtë fakt, si dhe nuk ka bërë përpjekje për të shmangur shkakun ligjor që çoi ERE-n në fillimin e procedurës për marrjen e masës administrative për heqjen e licencës.
- Në nenin 17, pika 4 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, parashikohet se *ERE përcakton dhe miraton pagesën rregullatore që paguhet prej të licencuarve, në përputhje me rregulloren përkatëse.*
- Në nenin 42, pika 1, gërma “ç” të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenin 5, gërma “ç” të “Rregullores për procedurat e heqjes së licensave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.04.2017, si dhe pikën 5.1, gërma “ç” të “Kushteve të licencës së veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike”, parashikohet se: *ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE.*
- Në nenin 9, gërma “c” të “Rregullores për procedurat e heqjes së licensave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.04.2017, parashikohet se:  
*Me marrjen e informacionit të detajuar me të dhënat sipas nenit 7 dhe 8 të kësaj rregulloreje, Bordi do të vendosë për:*  
*c) të hequr licencën subjekt i kushteve të përcaktuara në pikat "a", "b", "c", "ç" dhe / ose "d" të nenit 5 të kësaj rregulloreje në bazë të propozimit të paraqitur në raport, në përputhje me nenin 8 të kësaj rregulloreje.*
- Me heqjen e licencës nr. 360, Seria T17, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 37, datë 06.03.2017, shoqëria “Balkan Energy Trade” sh.p.k. nuk mban më statusin e të licencuarit nga ERE dhe nuk mund të ushtrojë më veprimtarinë për të cilën ishte licencuar.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

### **Vendosi:**

1. Të heqë licencën nr. 360, seria T17, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Balkan Energy Trade” sh.p.k. me vendimin e bordit të ERE-s nr. 37, datë 06.03.2017.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, licenca e sipërcituar bëhet e pavlefshme.

3. Grupi i Punës të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.